

Ma. Shkodran IMERAJ*Tribuna Shkencore**

“Dervish Shaqa-Demush Neziri dhe rapsodët e tjerë të Deçanit dhe rrethinës”

*Të nderuara Familje të dëshmorëve, veteranë dhe invalidë të luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
I nderuar z.Rasim Selmanaj, Kryetar i Komunës së Deçanit,
I nderuara Shkelësi Ambasador z.Islam Lauka, Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Prishtinë,
Të nderuara përfaqësues të Familjeve të veprimtarëve Ajët Gërguri, Ymer Berisha, Halim Spahiu, Gjon Sereqi, Marie Shllaku, Bernard Llupi, Xhemajl Abazit nga Vushtrria, Binak Alia-Mulosmanaj, Ramë Cacaj dhe Avdyl Bobi,
I nderuara kryetar i Bujanit historike,*

*Të respektuar të pranishëm,
Zonja dhe zotërinj.*

Sot ndihem tepër i nderuar që kam rastin të ju drejtohem me një kumtesë në këtë Tribunë Shkencore me titull “Dervish Shaqa-Demush Neziri dhe rapsodët e tjerë të Deçanit dhe rrethinës”, të organizuar nga Kuvendi i Komunës së Deçanit dhe Lidhja e Historianëve të Kosovës “Ali Hadri”-Dega në Deçan. Ky eveniment merr edhe më shumë rëndësi nga fakti së këtë vit, të gjithë shqiptarët ku do që janë shënojnë 100-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë.

Të flasësh për rapsodët e mirënjohur deçanas Dervish Shaqa dhe Demush Neziri, është e domosdoshme të rikthehemi në një retrospektivë të shkurtër historike.

Shqiptarët e Kosovës, gjatë Luftës së Dytë Botërore, u rreshtuan krahe koalicionit antifashist dhe ishin të bindur se pas kësaj lufte do të jenë të lirë që të vendosnin lirshëm, duke u bazuar në Rezolutën e Konferencës së Bujanit 31 dhjetor 1943 – 1 e 2 janar 1944, që shqiptarët e Kosovës shprehnin dëshirën dhe vullnetin për bashkim me Shqipërinë. Mirëpo,

* Kumtesë e lexuar në Tribunën Shkencore : “Dervish Shaqa-Demush Neziri dhe rapsodët e tjerë të Deçanit dhe rrethinës”, Deçan, 18 Korrik 2012. Tryezë e organizuar nga Lidhja e Historianëve të Kosovës “Ali Hadri”-Dega në Deçan dhe Drejtoria për Kulturë në Kuvendin e Komunës së Deçanit. Deçan, 18 Korrik 2012, Salla e Kuvendit të Komunës së Deçanit.

përfundimi i luftës do të shënonte edhe mbetjen e Kosovës nën Federatën e Jugosllavisë. Menjëherë pas luftës, shqiptarët e Kosovës u përballën me dhunë dhe terror të cilin me forcë e ushtronte sigurimi shtetëror jugosllav.

Ëndrra që populli shqiptar i Kosovës të bashkohej me Shqipërinë, mbeti vetëm një iluzion.

Dëshira për një Shqipëri të bashkuar, u ruajt me pasion në telat e çiftelisë, me anën e të së cilës Dervish Shaqa dhe Demush Neziri, si dhe rapsodët e tjerë, i kultivuan me një atdhedashuri të madhe. Ata me këngën e tyre, ruajtën kujtesën historike tek populli jonë. Ata mbeten frymëzues të brezave ta ardhëm se si duhet luftuar për lirinë dhe çlirimin e vendit. Me këngët e tyre, ata i kënduan bashkimit të shqiptarëve në një shtet të vetëm, ata i kënduan kryeheronjëve tanë si Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, Ismail Qemali, Isa Boletini, Bajram Curri, Idriz Seferi e shumë e shume figurave të tjera emblematike që lan gjurmë të pashlyera në analet e historisë së popullit shqiptar.

Kur zëmë në gojë për Deçanin dhe rrethinën, mund të themi së kjo treve e Rrafshit të Dukagjinit, ka një numër të madh të rapsodëve të cilët i takojnë gjeneratave të ndryshme.

Ndër rapsodët e gjeneratës së vjetër të trevës së Deçanin janë: Sadik Meta, Musë Alia, Dervish Shaqa, Demush Neziri, Lan Dobra, Ramë Dobra, Ukë Kuçi, Abaz Aga, Bajrush Doda, Zenun Gashi, Shaqë Avdia, Smajl dhe Brahim Aliqkaj, Hysen Uka, Musë Alia, Marash Krasniqi, Mon Sokoli, Rrahmon Imeri, Metë Hasanmetaj, Sadri Hasaj, Nimon dhe Osmon Mehmetaj.

Ndërsa rapsodët e gjeneratave me të reja janë : Ismet Mushkolaj, Homëz Lokaj, Kadri Moni, Januz Mushkolaj, Dervish Kuçi, Cenë Vishaj, Hajdar Doda, Zeqë Kuçi, Nimon Mushkolaj, Zekë Lushaj, Mhill Krasniqi, Zeqir dhe Azem Gecaj, Ismet Osdautaj, Mustafë Ramaj, Xhavit dhe Fatmir Nimonaj, Rizë Daci, Xhafer Bozhdaraj, Skender Vishaj, Brahim Molliqaj, Sokol Januzaj, Halil e Hysen Bajraktari, Shaban Mehmetaj, Enver Lekaj, Xhavit Hykosmani, Fatmir Miroci, Sejdi Gërvalla, Zenun Maksutaj, Xhavit Hykosmanaj, Fatmir Miroci, Ramadan Lushaj, Mentor Mushkolaj, Bekim Vishaj, Imer Baqaj, Rasim Osaj, Rrustem Krasniqi e shumë të tjerë.

Të nderuar të pranishëm,

Më lejoni që të paraqes disa të dhënë biografike për Dervish Shaqën dhe Demush Nezirin.

Dervish Shaqa u lind më 5 maj 1910, ndërsa, Demush Neziri me 10 mars të vitit 1912, që të dy në fshatin Llukë e Epërme të komunës së Deçanit.

Ata rrjedhin nga familje të shquara atdhetare. Që të dy, në moshën fëmijërore, kishin mësuar t'i binin sharkisë dhe çiftelisë, të cilat nuk i braktisën gjatë gjithë jetës së tyre.

Zërat e Dervish Shaqës dhe Demush Nezirit, kishin pushtuar Odat e Dukagjinit. Në dasmat dhe ahengjet e ndryshme, melosi i tyre autentik dhe tekstet e këngëve që këndonin, kishin rrëmbyer zemrat e shqiptarëve. Prandaj, të rralla ishin ato takime popullore, qofshin dasma apo ceremoni të tjera, e të mos ishin Dervishi dhe Demushi, të cilët ua shtonin madhështinë. Këngët që këndonin në atë kohë, u takonin cikleve të ndryshme, si këngëve të “arshikllekut”: “Po vijnë krushqit rronzit malit”, “N’ drrasë të vekit kush po kanë”, etj. Mirëpo, qysh herët, që të dy ishin brumosur me ide atdhetare shqiptare.

Në kohën e dimrit të ashpër e të stuhishëm, kur regjimi jugosllav nën dirigjimin e politikës së Aleksandër Rankoviqit, ndërmori të ashtuquajturin “Aksioni e Mbledhjes së Armëve”, nën tryshninë e pushtetit jugosllav, Dervish Shaqa dhe Demush Neziri, së bashku me kushëririn e tyre Adem Ramën dhe nën përcjelljen e mikut të tyre Isa Hoxha, u detyruan të largohen për në shtetin amë, Shqipërinë. Ata ishin të bindur se atje do të gjenin kohë dhe klimë më të mirë politike, por mesazhi të cilin e përcolli Dervish Shaqa në tela e sharkisë: “Kur ta ktheva Kosovë shpinën, e lash borë dhe e gjeta dimër”, ishte një sinjal i qartë se shteti shqiptar, nuk ishte ashtu siç e mendoni shqiptarët e e Kosovës.

Dervish Shaqa dhe Demush Neziri, edhe pas daljes në Shqipëri, e vazhduan traditën e këndimit të historisë së vendlindjes.

Në Rashbull, ata themelojnë grupin e rapsodit, i cili në vitin 1968 prezantohet për herë të parë në Festivalin e Folklorit Kombëtar në Gjirokastër. Që nga kjo kohë, ata, së bashku prezantojnë një varg këngësh, të cilat ende janë të njohura si: “Ç`janë këto gjam qe i bjen era”, “Prej Prokuple deri n`Nish”, “Moj e mira porsi bora”, e shumë e shumë të tjera, të cilat ruhen në Arkivin Qendror të Shtetit në Tiranë. Duhet theksuar se për këta rapsodë ka kompozuar edhe kompozitori Tish Daija, siç është kënga: “Festë të madhe ka sot Shqipëria”.

Dervish Shaqa vdiq me 11 prill 1985 në Rashbull të Durrësit, ndërsa, Demush Neziri më 04 prill 2001.

Të nderuar të pranishëm,

Dervish Shaqa dhe Demush Nezir, me këngët e tyre mbete frymëzim i shume rapsodëve të tjerë jo vetëm në trevën e Deçanit por edhe me gjerë. Ata me këngët e tyre ruajtën traditën tonë kombëtare dhe shpërmdanë vlerat e mirëfillta universale të shqiptarëve.

Të nderuar të pranishëm.

Sot Kosova është shtet i pavarur dhe sovran e i njohur ndërkombëtarisht. Në këtë ditë, kujtojmë të gjithë ata që dhanë jetën për lirinë dhe pavarësinë e këtij vendi. Sot, në vitin e jubileut të 100 të Pavarësisë së Shqipërisë, përkulemi me ndjenjën e respektit para të gjithë atyre që dhanë kontribut të madh dhe u flijuan për kauzën tonë kombëtare.

*Zonja dhe zotërinj,
Të nderuara të pranishëm.*

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë, që me rastin e shënimit të 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, në emër të Lidhjes së Historianëve të Kosovës "Ali Hadri"-Dega në Deçan, ti propozoj Kryetarit të Komunës së Deçanit z.Rasim Selmanaj, që të Shpallë Qytetar të Nderit të Deçanit, Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, Prof.dr. Sali Berisha.

Ju faleminderit për vëmendje.

RECENSIONE